



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOSŁJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

15.04.2021

THIRRJE PËR APLIKIM PROGRAMI PËR TRAJNIM NË PUNË për personat e riatdhesuar në Kosovë

Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) me mbështetjen e Departamentit për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar (DRPR) - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), shpallë thirrjen e hapur për aplikim për mbështetje nga programi për Trajnim në Punë (TNP) për **ndërmarrjet (punëdhënësit) e interesuar nga sektori privat dhe për personat e riatdhesuar në Kosovë të regjistruar si punëkërkues.**

Rreth Programit për Trajnim në Punë

Programi Trajnim në Punë (TNP) ka për qëllim ti ofrojë mundësinë punëkërkuesve të papunë që kanë nivel të kufizuar arsimor dhe nuk kanë përvojë të mëparshme të punës, të ndjekin një trajnim tre mujor në një ndërmarrje nga sektori privat. Gjatë periudhës së trajnimit, në emër të mbulimit të shpenzimeve elementare, kandidati do të kompensohet me **170.00 euro** në muaj. Me qëllim të përkrahjes së punësimit të qëndrueshëm në Kosovë, programi fokusohet në identifikimin e ndërmarrjeve që kanë potencial të ofrojnë mundësi afatgjata të punësimit. Në mënyrë që të përfitojnë nga programi, kandidatët e papunësuar dhe punëdhënësit duhet të regjistrohen në Zyren e Punësimit (ZP) në komunën e tyre.

Përveç përkrahjes së punëkërkuesve të papunë në gjetjen e mundësive për trajnim, programi TNP lehtëson gjithë procesin e identifikimit dhe përputhjes së punëkërkuesve me ndërmarrjet. Duke pasur parasysh vështirësitë me të cilat përballen ndërmarrjet private në gjetjen dhe angazhimin e stafit të aftësuar që kërkohet për zgjerimin e veprimtarive të tyre afariste, programi TNP do të angazhojë ekspertizën e ZP për të përputhur secilën pozitë të TNP me punëkërkuesit e përshtatshëm në harmoni me nevojat dhe kriteret e caktuara nga ndërmarrjet.

Programi TNP implementohet sipas hapave në vijim:

Hapi i parë - Shprehja e interesimit për të përfituar nga programi TNP:

Të gjitha ndërmarrjet e interesuara të sektorit privat mund të shprehin interesim për të përfituar, duke shkarkuar formularin për aplikim nga interneti në adresën: <https://aprk.rks-gov.net>. Përveç kësaj, formularët për aplikim janë gjithashtu të disponueshëm në ZP në të gjitha komunat. Formularit për aplikim duhet t'i bashkangjiten certifikata e regjistrimit të biznesit të ndërmarrjes që aplikon.

Punëkërkuesit potencial dhe kompanitë duhet të regjistrohen në ZP në komunën e tyre, nëse nuk e kanë bërë tashmë. Pas regjistrimit, punëkërkuesve do t'i ofrohen sesionet e para këshilluese nga këshilltari. Ndërmarrjeve do t'iu kërkohet të dëshmojnë që janë të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK).

Hapi i dytë: Këshilltarët në ZP do të konsultojnë/ndërmjetësojnë procesin dhe identifikojnë një ndërmarrje të përshtatshme për punëkërkuarit e regjistruar nga Sistemi i Menaxhimit të Informatave të Punësimit (SMIP). Ndërmarrjet duhet të ofrojnë dëshmi që janë të gatshme t'i trajtojnë punëkërkuarit. Pas këtij procesi, nënshkruhet një marrëveshje për TNP ndërmjet punëkërkuarit dhe punëdhënësit, ku përcaktohen përgjegjësitë e secilës palë. QAP do të përpilojë planin individual të trajnimit, në bashkëpunim me ndërmarrjen.

Programi mbulon shpenzimet elementare të punëkërkuarve gjatë periudhës së trajnimit, gjë që ofron një stimulim për punëdhënësit që t'i aftësojnë ata për një punësim afatgjatë brenda ndërmarrjes.

Kush mund të aplikojë?

1. Ndërmarrjet private

Për pjesëmarrje në program, mund të aplikojnë **të gjitha ndërmarrjet (punëdhënësit) e interesuar** të regjistruar në ZP. Ndërmarrjet duhet të jenë të regjistruara në ARBK dhe të jenë taksapagues aktiv në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK).

Formulari i aplikimit mund të gjendet në internet, në adresat elektronike <https://apr.kks.gov.net/Content/News/Index> ose <https://mpms.kks.gov.net>si dhe në ZP në secilën komunë.

Kush nuk mund të aplikojë?

- Organizatat jo-qeveritare;
- Veprimtaritë financiare dhe të sigurimeve, veprimtaritë që përfshijnë bixhozin, sallonet e masazheve;
- Prodhimi i pijeve me përmbajtje të lartë të alkoolit;
- Prodhimi dhe shpërndarja e armëve;
- Prodhimi që përdor teknologji që çojnë në ndotje të mjedisit (si ndotje të ajrit, ujit, tokës etj.);
- Bizneset jo-formale dhe qendra të thirrjes me aktivitet të dyshimt biznesor.

2. Personat e riadhesuar të regjistruar si punëkërkuar të papunë

Të gjithë personat e riadhesuar në Kosovë (në 5 vitet e fundit) të regjistruar si punëkërkuar në ZP, që nuk kanë përvojë të mëparshme të punës, mund të përfitojnë nga programi TNP.

Prioritet do të kenë:

- Gratë,
- Pakicat etnike.
- Personat me aftësi të kufizuara,
- Prindërit vetëushqyes.

Të gjithë të interesuarit duhet të regjistrohen në ZP në komunat e tyre përkatëse.

Rastet e konfliktit të interesave me palët e përfshira dhe vendimmarrësit e programit për TNP, nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga ky program (antarë të familjes së ngushtë). **Personat të cilët kanë përfituar më herët nga programi i subvencionimit në pagë apo nga programi i vetpunësimit, nuk mund të përfitojnë nga kjo skemë.**

Afati i aplikimit 15.04.2021-30.05.2021

Mbështetja financiare për punëkërkuessit

Kostoja e aftësimit të punëkërkuessve mbulohet nga programi. Kompensimi në shumën **170.00 euro** në muaj i bëhet drejtëpërdrejtë të trajnuarit në llogarinë bankare personale gjatë trajnimit tre mujorë. Kjo poashtu ofron një stimulim për punëdhënësin që të aftësojë një punëkërkuess për punësim afatgjatë brenda ndërmarrjes. Pagesat punëkërkuessit i bëhen në baza mujore për t'i mbuluar shpenzimet elementare gjatë trajnimit (udhëtimi, ushqimi). Ndërmarrjet inkurajohen që ta punësojnë punëkërkuessin pas përfundimit të trajnimit.

Punëkërkuessit pas përfundimit të trajnimit do të pajisen me çertifikatë të vijimit të trajnimit nga Qendra e Aftësimit Profesional (QAP), e cila shërben si dokument referues i aftësive për ta mbështetur punëkërkuessin dhe mund të jetë përparësi për atë gjatë kërkit të punës në të ardhmen.

Si të aplikohet?

- **Ndërmarrjet e interesuara private** duhet të dorëzojnë **formularin e aplikimit të plotësuar** në ZP në komunën e tyre. Formulari i aplikimit është i disponueshëm në internet në adresat elektronike: <https://apr.k.s-gov.net/Content/News/Index> ose <https://mpms.k.s-gov.net> si dhe i printuar në secilën ZP në tërë Kosovën. Aplikantët duhet bashkangjitur në aplikacion çertifikatat e tyre për regjistrimin e biznesit. Ndërmarrjet do të kontaktohen nga ZP me një listë të kandidatëve potencial.
- **Punëkërkuessit e riatdhesuar** të interesuar për vendet e lira duhet të regjistrohen në ZP në komunat e tyre ose të vizitojnë ZP ku ata tashmë janë regjistruar dhe të informojnë këshilltarët e tyre të punësimit në lidhje me interesin e tyre.

Informacione tjera

Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni Zyret e Punësimit në komunën tuaj.

Në rast se keni pyetje në lidhje me programin TNP, ju lutem kontaktoni projektin ALMP2/UNDP në adresën elektronike: almp.ks@undp.org.

Rreth projektit ALMP2 në UNDP Kosovë

Objektivi kryesor i Programeve Aktive të Tregut të Punës (PATP2/ALMP2) është përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve të tregut të punës për të hartuar politikat relevante të përgjegjshme-gjinore në nivelin qendror dhe ofrimi i shërbimeve të integruara në nivel lokal, duke u fokusuar në grupet më të cënueshme në mesin e të papunëve. Gjithashtu, projekti ofron mundësi për punësim dhe trajnim për personat e papunë

COVID-19

KUJDES I VEÇANTË gjatë procesit të aplikimit:

- Bartja e maskave, mbajtja e distances dhe larja e duarve sipas udhëzimeve nga IKSHS-së dhe OBSH-së.
- Në çdo zyre do të mbahet distanca në të gjitha hapësirat prej 2 metrave.
- Asnjë aplikues nuk lejohet të hyjnë brenda institucioneve pa maskë.